


Kërkimi Shkencor dhe Zhvillimi, 2024

Tiranë, më 29 Dhjetor 2025: Instituti i Statistikave (INSTAT) publikon për herë të parë statistikën mbi fondet e alokuara nga buxheti i shtetit për aktivitetin e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit (GBARD).

Në vitin 2024, fondet e buxhetit të shtetit të dedikuara për aktivitetet e kërkimit shkencor dhe zhvillimit në Shqipëri përbënin 0,3 përqind të Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Pjesa më e madhe e financimit iu akordua Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), të cilat përfituan 54,7 përqind të totalit të fondeve të alokuara, të ndjekura nga sektori qeveritar me 43,8 përqind, si dhe sektori privat jofitimprurës me 1,5 përqind. Sipas klasifikimit të objektivave socio-ekonomike (NABS), në vitin 2024, pjesa më e madhe e fondeve të alokuara u orientua drejt objektivit “Përmirësimi i përgjithshëm i njohurive: Kërkim dhe zhvillim i financuar nga fondet e përgjithshme universitare”, i cili zë 52,6 përqind të fondeve gjithsej.

Grafiku 1. Fonde të alokuara sipas klasifikimit të objektivave socio-ekonomike (NABS).



*FPU -fondet e përgjithshme universitare

Për publikim 29/12/2025

Metodologjia

Ky botim jep informacion statistikor mbi fondet e alokuara nga buxheti i shtetit për aktivitetin e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit (statistikat GBARD) sipas objektivave socio-ekonomike, duke përfshirë gjithashtu të gjitha fondet për programet ndërkombëtare të K&Zh.

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave GBARD kryhet sipas udhëzimeve të Manualit Frascati 2015 të OECD (Guidelines for Collecting and Reporting Data on Research and Experimental Development, The Measurement of Scientific, Technological and Innovation Activities), i cili është standardi ndërkombëtar i njohur për mbledhjen e statistikave të K&Zh.

Statistikat GBARD grumbullohen dhe përpunohen me baza vjetore nga institucionet shtetërore dhe institucionet e arsimit të lartë. Të gjitha të dhënat trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe publikohen në formë agregate.

Të dhënat GBARD paraqiten sipas dy dimensioneve kryesore:

Objektivat socio-ekonomike – në përputhje me Nomenklaturën për analizën dhe krahasimin e programeve dhe buxheteve shkencore (NABS 2007). Kjo klasifikim e ndan financimin publik të K&Zh sipas qëllimeve kryesore të shpenzimeve.

Mënyra e financimit – përfshin financimin e projekteve dhe financimin institucional (të dhëna jo-obligative).

Përkufizimet e variablave bazë

“Kërkimi dhe Zhvillimi (K&Zh)” përbëhet nga një punë kreative dhe sistematike e ndërmarrë me qëllim të rritjes së stokut të njohurive - duke përfshirë njohuritë për njerëzimin, kulturën dhe shoqërinë - dhe për të krijuar aplikacione të reja nga njohuritë e fituara.

Kërkimi shkencor përfshin punën kreative dhe hulumtimin origjinal të ndërmarrë mbi baza sistematike për të fituar njohuri të reja, duke përfshirë njohuritë për njerëzimin, kulturën dhe shoqërinë.

Statistikat mbi fondet e alokuara nga buxheti i shtetit për Kërkim Shkencor dhe Zhvillim (GBARD - Government Budget Allocations for R&D): Të gjitha alokimet e buxhetit të shtetit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin (K&Zh), duke përfshirë financimin për sektorët qeveritar, arsimin e lartë, biznesin privat jofitimprurës etj. Të dhënat lidhen me parashikimet e buxhetit, jo me shpenzimet në fund të vitit kalendarik.

Financimi i projekteve: Fondet e dedikuara për një grup ose individ për të kryer një aktivitet K&Zh të kufizuar në hapësirë, kohë dhe buxhet, zakonisht bazuar në një propozim projekti.

Financimi institucional: Fondet e dedikuara direkt institucioneve.

Programe sipas koordinimit ndërkombëtar: Organizata ndërqeveritare ose institucione të Komisionit Evropian që kryejnë K&Zh me pajisjet e tyre kërkimore (p.sh., CERN, EMBL, ESO).

Programet publike dypalëshe ose shumëpalëshe të K&Zh-së, të krijuara nga qeveritë e shteteve anëtare të BE-së (dhe shtetet kandidate ose ato të EFTA-s), përfshijnë iniciativa të financuara nga Komisioni Evropian dhe të realizuara nga të paktën dy qeveri të shteteve anëtare. Edhe pse këto programe mund të përfshijnë shtete të tjera joanëtare të BE-së, ato mund të përmbajnë ose jo flukse të financimit ndërkufitar (jashtë kufinjve të BE).

Objektivat socio-ekonomike : Ndarja e fondeve sipas qëllimeve kryesore të shpenzimeve për K&Zh, në përputhje me NABS 2007, e cila lidh financimin publik me prioritetet politike dhe socio-ekonomike.

Për klasifikimin e të dhënave përdoret Nomenklatura për analizën dhe krahasimin e programeve dhe buxheteve shkencore (NABS 2007).

NABS është një klasifikim funksional për analizën e financimit publik të kërkimit dhe zhvillimit (K&ZH) në bazë të objektivave socio-ekonomikë të ndjekur nga qeveritë qendrore ose të deklaruar prej tyre në hartimin e buxheteve dhe programeve të tyre sipas Manualit të Frascatit (OECD).

Kreu	NABS	Kategoritë NABS për objektivat socioekonomik të K&ZH
1	NABS01	Eksplorimi dhe shfrytëzimi i tokës
2	NABS02	Mjedisi
3	NABS03	Eksplorimi dhe shfrytëzimi i hapësirës
4	NABS04	Transport, telekomunikim dhe infrastrukturë tjetër
5	NABS05	Energji
6	NABS06	Teknologji dhe prodhim industrial
7	NABS07	Shëndetësi
8	NABS08	Bujqësi
9	NABS09	Edukim
10	NABS10	Kulturë, rikrijim, besim fetar dhe media masive
11	NABS11	Sisteme politike dhe shoqërore, struktura dhe procese
12	NABS12	Përmirësimi i përgjithshëm i njohurive: K&ZH i financuar nga fondet e përgjithshme universitare (FPU)
13	NABS13	Përmirësimi i përgjithshëm i njohurive: K&ZH i financuar nga burime të tjera fondesh përjashtuar FPU
14	NABS14	Mbrojtje